



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 12, datë 26.01.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKQYRËS DHE  
NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “EUROSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/ shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/ mbikëqyrës, administratorit/ anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, të Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e emërimit të z. Aleksandër Biberaj, në pozicionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare, deri më datë 10.11.2025.**
- 2. Miratimin e ndryshimit të nenit 16, pika 16.2, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., si pasojë Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë së sigurimit bëhet me 3 (tre) anëtarë.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**